



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DELVINË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Delvinë, më _____.____. 2024

PROCES VERBAL - Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“RIPARIM I URËS SË VANËS, FSHATI VANË, BASHKIA DELVINË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Punime ndërtimi – 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 22,310,821 *(njëzetë e dy milionë e treqindë e dhjetë mijë e tetëqindë e njëzetë e një)* lekë pa përfshirë vleftën e TVSH-së.

- Financimi për Vitin 2024 do të jetë 13,386,493 (trembëdhjetëmilionë e treqindë e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqindë e nëntëdhjetë e tre) lekë duke përfshirë vleftën e TVSH-së;
- Financimi për Vitin 2025 do të jetë 13,386,493 (trembëdhjetëmilionë e treqindë e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqindë e nëntëdhjetë e tre) lekë duke përfshirë vleftën e TVSH-së;

Burimi i financimit: Ky objekt financohet nga Buxheti i Shtetit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 307, datë 22.05.2024 “Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 1106 Prot, datë 27.05.2024, shkresës Nr. 1036/4 Prot, datë 25.06.2024 të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile “Mbi aplikimin në programin Emergjencat Civile 2024” protokolluar me Nr. 1393 Prot, datë 28.06.2024.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Delvinë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast te bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 26, pika 2 dhe neni 39, pika 7 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1, të shoqëruar me listën e çmimeve sipas zërave të preventivit (Shtojca 2);

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së, dhe nenin 26, dhe 29 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, (Shtojca 7).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga ana e Operatorit Ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiarë (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Tatimore, të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. (Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit Nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të jetë jo më pak vlera e parashikuar e kontratës dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 dhe këstin përkatës të maturuar për vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d)*

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

1.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim;
 - Fatura tatimore të situacionit përfundimtar

➤ Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

➤ Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomik mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar*. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **N.P-1A** (Punime gjurmimi);
- **N.S-8A** (Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri);
- **N.P-5A** (Punime nëntokësore, ura e vepra arti)
- **N.P-12A** (Punime të inxhinierisë së mjedisit)
- **N.S-19A** (Sisteme kundra zhurmës për infrastrukturë)
- **N.S-6A** (Sinjalistike rrugore jo ndricuese)
- **N.S-18** (Punime topogjodezike)

Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016 “*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*” Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Kat.7 b** (Projektim Ura dhe Vepra Arti mbi 10 m)

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të*

zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në Lidhjen 2, 3 dhe 4 të VKM-së Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrorjnë Veprimtari Ndërtimi”

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

KAT.	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-1 Kat 7 b	Punime gërmimi në tokë Projektim Ura dhe Vepra Arti mbi 10 m	Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , në kanale gjerësi > 2 m, prani uji ~ 1m, kategoria III, me shk në tokë	Niveli A
		Gërmim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , në kanale gjerësi > 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet	
		Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , në kanale gjerësi > 2 m, prani uji ~1m, kategoria III, me shk në mjet	
		Çmontim + montim ura bel	
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Cmontim + montim ura bel	Niveli A

		<p>Prishje kollona, trare b/a. (pilat e dëmtuara)</p>	
		Mbushje me zhavorr pas mureve	
		<p>Mbushje me gur kave</p> <p>Shpim me sonda "UKS" Ø 1m, ~ 20 m, tokë zhavore.</p>	
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit	<p>Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 2.0 km</p>	Niveli A
		Mbushje me gur kave	
		Mbushje me zhavorr pas mureve	

		Shtrese zhavor lumi t=20cm	
NS-8	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri	Struktura monolite betoni me çakëll C 16/20	Niveli A
		Struktura monolite betoni me çakëll C 20/25 (Riparim kaskada)	
		Struktura monolite betoni me çakëll C 25/30	
		Struktura monolite betoni me çakëll C 30/37	
		F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10 mm	
		F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12 mm	
		Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum	
N.S-19	Sisteme kundra zhurmës për infrastrukturë	Struktura monolite betoni C 16/20	Niveli A

N.S-6	Sinjalistike rrugore jo ndricuese	FV tabela të ndryshme rrugore D=60cm	Niveli A
N.S-18	Punime topogjodezike	Shpim me sonda "UKS" Ø 1m, ~ 20 m, tokë zhavore.	Niveli A

Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme (sipas Lidhjes 3)

- Kategoria NP-1 A (Punime gjërmimi në tokë)

Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve të cilat përfshijnë Gjërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, në kanale gjerësi > 2 m, prani uji ~ 1m, kategoria III, me shk në tokë, Gjërmim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m³, në kanale gjerësi > 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet, Gjërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, në kanale gjerësi > 2 m, prani uji ~1m, kategoria III, me shk në mjet, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për keto punime.

- Kategoria NP-12 A (Punime të inxhinierisë së Mjedisit)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitetet botanik.

Referuar zërave të preventivit kemi të bëjmë me punime si Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 2.0 km, Mbushje me gur kave, Mbushje me zhavorr pas mureve, Shtresë zhavorr lumi t=20cm. Gjatë zbatimit të projektit në realizimin e plotë të kontratës është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina e inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmëri dhe në kohë reale. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për keto punime.

- Kategoria NP-5 A (Punime nëntokësore, ura e vepra arti)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse, punime të urave e veprave të artit. Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve të cilat përfshijnë punimet Për Çmontim + montim ura Bel, Prishje kollona, trarë b/a. (pilat e dëmtuara), Shpim me sonda "UKS" Ø 1m, ~ 20m, tokë zhavore, këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për keto punime.

- Kategoria NS-8 A (Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri)

Konsiderohet prodhimi në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të parandëruar. Prodhimi në kantjer dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve të cilat përfshijnë punimet Struktura monolite betoni me çakëll C16/20, Struktura monolite betoni me çakëll C20/25 (Riparim kaskada), Struktura monolite betoni me çakëll C25/30, Struktura monolite betoni me çakëll C 30/37, F V hekur betoni i zakonshëm Ø 6 ~ 10mm, F V hekur betoni i zakonshëm Ø > 12mm, Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për keto punime.

- Kategoria NS-19 A (Sisteme kundra zhurmës për infrastrukturë)

Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru, xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zë izoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve.

Në këtë objekt parashikohen të kryhen punime si Struktura monolite betoni C 16/20. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për keto punime.

- Kategoria NS-6 A (Sinjalistike rrugore jo ndricuese)

Konsiderohet vendosja e sinjalistikës rrugore jo ndricuese, si tabela të qarkullimit rrugorë dhe sinjalistikës rrugore.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve kërkohet përsa i përket FV tabela të ndryshme rrugore D=60cm. Referuar punimeve të mësipërme operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë.

- Kategoria NS-18 A (Punime Topogjeodezike)

Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime special gjeodezike; rrjeta....

Në këtë objekt përfshihen edhe punime: si piketimi, rievime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme, caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhornime të ndryshme dhe lidhjet me sistemet koordinative relative dhe absolute. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për keto punime.

- Kategoria KAT-7 B (Projektim Ura dhe Vepra Arti mbi 10 m)

Konsiderohet projektimi i urave të tipit Bel, ura beton arme etj..., me një gjatësi ure mbi 10 m.

Në këtë objekt përfshihen Çmontim + montim ura Bel. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori licence projektimi.

2.3.3 a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe në licencën e projektimit si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi (**profili Rrugë-Ura**) 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune,
- Diplomën Universitare,
- Librezë pune.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM-së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

b) Gjithashtu, OE duhet të kenë si staf mbështetës, **Inxhinier Strukturist 1 (një) , Inxhinier Hidroteknik 2 (dy) dhe Inxhinier Mekanik 1 (një).**

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune;
- Diplomën universitare;
- Duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM-në Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.*

*Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.*

Kriteri për stafin teknik kryesor lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit i Profilat Rrugë/Ura (një)** kërkohet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të urës që do të çmontohet dhe montohet përsëri dhe të ndërtimit të pilës së re lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.
- **Inxhinieri Mekanik (një)** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, ku përfshihet çmontimi dhe montimi i elementëve mekanikë të urës.
- **Inxhinieri Hidroteknik (dy)** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve Struktura monolite betoni me çakëll C 20/25 (Riparim kaskada), Mbushje me gur kave për kaskadën, Struktura monolite betoni me çakëll C 25/30, lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.
- **Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder (një)** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike duke përfshirë punime si piketimi, rlevime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhornime të

ndryshme, përse i përket piketimit të pilës së re, mureve të betonit si dhe piketimin e Shpimit me sonda "UKS" Ø 1m, ~ 20m, tokë zhavore.

- **Inxhinieri i Mjedisit (një)** është përgjegjës për zbatimin e zërave të preventivit ku kemi të bëjmë me punime mbushje me gur kave, mbushje me zhavorr pas mureve, shtresë zhavorr lumi t=20cm, dhe punime gjurmimi, ndërtimi i terreneve të jashtme, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjatë zbatimit të projektit në realizimin e plotë të kontratës, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina e inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmëri dhe në kohë reale.
- **Inxhinier Ndërtimi i profilit Strukturist (një)** kërkohet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore si struktura monolite betoni C 16/20, struktura monolite betoni me çakëll C 25/30, struktura monolite betoni C 30/37 lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.

2.3.4 a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të kenë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit sipas kodit të profesionit, punonjësit specialistë të kualifikuar, të vërtetuar me dëshmi kualifikimi profesionale, certifikata ose diploma ose çertifikata të shkollës profesionale përkatëse për secilin specialitet të lëshuar nga institucione të licënuara nga organet përkatëse, kontratë pune individuale, me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------------|---------|
| - Montator për konstruksione metalike | 1 (një) |
| - Karpantier | 2 (dy) |
| - Betonues | 2 (dy) |
| - Hekurkthyes | 1 (një) |
| - Saldator | 1 (një) |
| - Hidroizolues | 1 (një) |
| - Punime në rrugë | 1 (një) |
| - Eskavatoristë | 2 (dy) |
| - Automakinist | 1 (një) |

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Gjithashtu OE, duhet të plotësojnë tabelën në vijim:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjekte të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar. Kjo kërkesë po ashtu është në përputhje me vendimin nr. 441/2020, datë 09.10.2020 të Komisionit të Prokurimit Publik. Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licensuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

Për eskavatoristët dhe automakinistin punonjësit duhet të jenë të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR.

Argumentimi: Kërkesat e germës c) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh” dhe VKM-në Nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Karpentier 2 (dy)** janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen punime betoni, kallëpet, shtresat dhe hekuri periodik i ndërtimit etj. Konkretisht Struktura monolite betoni C 16/20, Struktura monolite betoni me çakëll C 20/25 (Riparim kaskada), Struktura monolite betoni me çakëll C 25/30, Struktura monolite betoni C 30/37. Referuar grafikut të punimeve punimet konstruktive shpërndahen në 55 ditë. Në bazë të zërave dhe sasive që përfshihen në preventivin e kontratës si dhe në ecurinë reale të punimeve të këtij lloji, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin nga ana e ofertuesve të 2 (dy) karpentierëve, është në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.
- **Hekurkthyes 1 (një)** janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen përpunimi dhe lidhja e hekurit të ndërtimit, kryesisht për punimet konstruktive për urën. Punimet konstruktive shpërndahen në 55 ditë referuar grafikut të punimeve, gjatë së cilave një numër prej 1 hekurkthyesi, është menduar si optimal për realizimin në kohë të objektit të kontratës.

- **Hidroizolues 1 (një)** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të hidro-izolimit në dysheme, me materialin e duhur sipas zërave të preventivit të punimeve.
Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, janë parashikuar zërat:

- *2.195 Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum*

- **Betonues (dy)** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonimit si Konkretisht Struktura monolite betoni C 16/20, Struktura monolite betoni me çakëll C 20/25 (Riparim kaskada), Struktura monolite betoni me çakëll C 25/30, Struktura monolite betoni C 30/37. Referuar grafikut të punimeve punimet konstruktive shpërndahen në 55 ditë.
Në bazë të zërave dhe sasive që përfshihen në preventivin e kontratës si dhe në ecurinë reale të punimeve të këtij lloji, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin nga ana e ofertuesve të 2 (dy) betonuesve, është në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.
- **Saldator 1(një)** është i nevojshëm për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Montator për konstruksione metalike 1(një)** është i nevojshëm për përpunimin, prerjen, bashkimin dhe montimin e elementeve metalik, në konstruksione prej metali si Çmontim + montim ura Bel.
- **Punime në rrugë 1 (një)** është i nevojshëm për punimet që do të kryhen përkatësisht zërat Shtresë zhavor lumi t=20cm, mbushje me gurë kave dhe mbushje me zhavorr pas mureve.
- **Eskavatorist 2(dy)** të nevojshëm për punimet me eskavator dhe minieskavator ku përfshihen gërmimet sipas zërave të preventivit.
- **Automakinist 1(një)** është i nevojshëm për përdorimin e autovincit, asfaltoshtrueses etj, në përputhje me zërat e preventivit.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në stafin e tij 1(një) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar, dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM-në Nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar).

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës e vlefshme
- Diplomë
- Urdhër Mjeku

Nëse OE nuk kanë në stafin e tyre personal përgjegjës me aftësi dhe kualifikimet e duhura lidhur me çështjet e shëndetit në punë (nëse nuk kanë mjek të punësuar) mund ti sigurojnë këto shërbime me anë marrëdhënieve kontraktore (të paraqitet kontrata e vlefshme, diploma universitare dhe licenca përkatëse për ushtrimin e profesionit) me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë pikat dhe nënpikat e tij duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Argumentimi: Është kërkuar një mjek bazuar në VKM-në Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 692, datë 13.12.2001, të Këshillit të Ministrave” përmasat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë” është përcaktuar:

"2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike.

c) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre 2 (dy) ekspert për dhënien e ndihmës së parë.

Për këtë operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

- kontratën individuale të punës;
- certifikatë/dëshmi kualifikimi.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

d) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë

dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-në Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-në Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-në Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit te cilet janë të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" dhe "Ekspert për ndihmën e parë", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

*Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.4 duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Tre muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave si dhe shoqëria të ketë një punësim mesatar prej 30 punonjësish. Përjashtim nga kjo bëjnë vetëm “Mjeku i përgjithshëm”, i cili, përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listpagesat e tij) mund të jenë edhe me kontrata pune individuale. Ndërsa punonjësit e kualifikuar si (eskavatoristë , automakinistë), të cilët***

përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listpagesat e tij) mund të jenë të kontraktuar vetëm në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qira.

➤ Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Tre muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv.

Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në bazë të volumeve dhe grafikut të punimeve.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton.	3 copë	Në pronësi ose me qera
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 18 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
3.	Sondë me zinxhir dhe diametër $\Phi 80 \sim \Phi 100$	1 copë	Në pronësi ose me qera
4.	Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
5.	Rrul ngjeshës 8-12 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
6.	Grejder	1 copë	Në pronësi ose me qera

7.	Pirun për ngritje në lartësi	1 copë	Në pronësi ose me qera
8.	Autobetoniere	3 copë	Në pronësi ose me qera
9.	Eskavator me zinxhir	2 copë	Në pronësi ose me qera
10.	Autovinç	1 copë	Në pronësi ose me qera
11.	Eskavatorë krahgjatë me gjatësi krahu deri në 18 m	1 copë	Në pronësi ose me qera
12.	Fadrom me goma	2 copë	Në pronësi ose me qera
13.	Autobot Uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
14.	Minieskavator	1 copë	Në pronësi ose me qera
15.	Rimorkiator	1 copë	Në pronësi ose me qera
16.	Autopomp betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
17.	Fabrikë për prodhimin e betonit, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje ndërtimi, Zhdoganim të linjës së betonit, Leje Mjedisore Kodi III.1B, Aktin e miratimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit) e vendosur jo më larg se 30 km nga objekti në pronësi/me qera/kontratë furnizimi.	1 copë	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
18.	Fabrikë për prodhimin e materialeve inerte, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje ndërtimi, Zhdoganimin e linjës, Leje Mjedisore Kodi III.1B, Leje minerare) objekti të jetë: në pronësi/me qera/kontratë furnizimi.	1 copë	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
19.	Karrier për Prodhimin e gurit, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje ndërtimi, Leje Mjedisore Kodi III.1B , Leje minerare) objekti të jetë: pronësi/me qera/kontratë furnizimi.	1 copë	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi

- Kokore minimumi 35 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 3 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë
- Motogjenerator 1 copë
- Motosaldatrice 1 copë

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik;
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.
- f) pagesa e taksave të mjetit
- g) leje transporti e lëshuar nga njësia vendore.

Kur janë me qira, duhet të paraqitet:

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik;
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.
- f) pagesa e taksave vjetore.
- g) leje transporti e lëshuar nga njësia vendore.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera, si dhe të deklarojë se pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës dëshmon se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fituese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton (3copë) dhe Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 18 ton (1 copë);** Kërkohet kamioni përkatës pasi kemi transport të lëndëve inerte, si dhe transporti i volumeve që dalin nga punimet e gërmimit dhe të prishjeve të këmbëve ekzistuese prej betoni si dhe të mbushjeve me material inert e zhavorr etj.
- **Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton (1 copë);** prezenca në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe proceset si transport i materialeve te hidroizolimit, hekurit etj. Ky mjet është i favorshëm pasi mund të qarkulloj në cdo orar.
- **Autovinç 1 (copë);** prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe konsiston në ngritjen e materialeve të rënda sipas kërkesave dhe nevojave të projektit.
- **Eskavator me zinxhir (2 copë) dhe Eskavatorë krahgjatë me gjatësi krahu deri në 18 m;** Kërkohet për gërmimet në objekt dhe thellimin e kaskadës sipas kërkesave dhe

nevojave të projektit. Thellimet do të kryhen me eskavator krahgjatë me gjatësi krahu deri në 18 m për arsye se eskavatorët normal nuk e kryejn dot funksionin e tyre për shkak të terrenit dhe skarpatës me lartësi të madhe.

- **Minieskavator (1 copë)**; Kërkohe për gërmime të vogla të cilat do të bëhen në shesh për pastrimin e mbetjeve nga prishjet e këmbëve në vendet ku nuk i arrin fadroma me goma.
- **Sondë me zinxhir dhe diametër $\Phi 80 \sim \Phi 100$ (1 copë)**; Referuar preventivit në këtë projekt përfshihet dhe Shpim me sonda "UKS" $\emptyset 1m$, $\sim 20m$, tokë zhavore për pilotat e këmbëve të urës.
- **Rrul ngjeshës 8-12 ton (2 copë)**; kërkohe pasi kemi punime si shtresë zhavorr lumi $t=20$ cm të cilat kërkojnë ngjeshje me rrul si dhe ngjeshje të tokës nën këmbët e urës.
- **Grejder (1 copë)**; prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e nivelimit të shtresës së zhavorrit të lumit $t=20$ cm dhe nivelimit në sipërfaqen e këmbës së urës.
- **Pirun për ngritje në lartësi (1 copë)**; Kërkohe për ngritje në lartësi të elementëve të vogla të urës dhe të hekurit në vende që autovinci e ka të pamundur të kryej funksionin si në sipërfaqe të vogla etj.
- **Autobetoniere (3 copë)**; prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, konkretisht furnizimin me beton për strukturat beton-arme si pilot, këmbët e urës etj.
- **Fadrom me goma (2 copë)**; kërkohe pasi kemi punime mbushje me zhavorr pas mureve dhe mbushje me gur kave, ngarkimin e makinerive të transportit si dhe hapjen e materialit inert që do të vij në objekt. Referuar volumit të preventivit është parë e nevojshme disponimi i makinerive.
- **Autobot Uji (1 copë)**; është i nevojshëm për spërkatjen me ujë para betonimit të kallëpit të betonit si dhe ujitjen me ujë pas betonimit të betonit sipas Kushteve Teknike të Zbatimit në fuqi.
- **Rimorkiator (1 copë)**; është i nevojshëm për transportimin e makinerive të rënda në kantier. Ky mjet është parë i nevojshëm për kryerjen me efektivitet të punës brenda kohës të caktuar sipas grafikut të punimeve.
- **Autopomp betoni (1 copë)**; kërkohe pasi shërben për hedhjen e betonit në vepër nga betonieret. Referuar volumit të preventivit është parë e nevojshme disponimi i makinerive.
- **Fabrikë për prodhimin e betonit, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje ndërtimi, Zhdoganim të linjës së betonit, Leje Mjedisore Kodi III.1B, Aktin e miratimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit) e vendosur jo më larg se 30 km nga objekti si dhe fabrika të jetë në një nga format: në pronësi/me qira/kontratë furnizimi (1 copë)**; nevojitet për furnizimin me beton të veprës. Sipas Kushteve Teknike të Zbatimit seksioni i hedhjes së betonit në vepër ku shprehimisht lidhet me “Uljen e konusit të Abrahams” dhe “Ngurtësimit të betonit” citon që betoni duhet të hidhet në vepër 1 orë nga momenti i hedhjes në makinerin e transportit. Për shkak dhe të temperaturave të larta në

periudhën e verës (mbi 37 gradë) dhe trafikut të dendur në rrugën nacionale Sarandë-Gjirokastër Fshati Vanë (vendodhja e objektit) është parë e nevojshme që fabrika të kërkoet me një largësi prej 30 km nga vendodhja për të garantuar cilsinë e betonit dhe hedhjen e tij në vepër brenda parametrave të Kushteve Teknike të Zbatimit.

- **Fabrikë për prodhimin e materialeve inerte, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje ndërtimi, Zhdoganimin e linjës, Leje Mjedisore Kodi III.1B, Leje minerare) objekti të jetë në një nga format: në pronësi/me qira/kontratë furnizimi (1 copë);** nevojitet për furnizimin me material inert të veprës. Përkatësisht në zërat Mbushje me zhavor pas mureve dhe shtresë zhavor lumi.
- **Karrier për Prodhimin e gurit, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje ndërtimi, Leje Mjedisore Kodi III.1B, Leje minerare) objekti të jetë në një nga format: pronësi/me qira/kontratë furnizimi (1 copë)** nevojitet për furnizimin me material të veprës. Përkatësisht në zërat Mbushje me gur kave.
- **Motosaldatrice (1 copë);** prezenca në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për saldimin e elementëve të urës.
- **Motogjenerator (1 copë);** prezenca në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me garantimin me energji elektrike gjatë gjithë kohës në kantierin e ndërtimit.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe menaxhimit të energjisë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 45001 – 2018** mbi “Shëndetin dhe Sigurimin në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i*

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 14 gërma është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____ - Kryetar

(Emri, Mbiemri, Firma)

2. _____ - Anëtar

(Emri, Mbiemri, Firma)

3. _____ - Anëtar

(Emri, Mbiemri, Firma)